

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Restaurohen manastiret e Gjirokastrës
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/restaurohen-manastiret-e-gjirokastres-i588866
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 07:49:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 13:46:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7a4e55ecfa9adfde053cd5bf375e4b7c6e48d1628a26a8e0cfb36d482708e81f
TEKSTI	39a74e33c0cd9497fcc9243c202d2d4ba5cce9068b80b9cd64bd6cb2c24717b5
PAMJA	6442cbb0c4b0db9eeea4f9e709e1abf28108314bb6c0fb74ff5ba253ea893d38

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c092e7d1e089d0585bfdd520eb39fd92a93e822fbd1fc20dd7a7cd8b26a37885
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f736abde33fe298fdab4b0ac01389ddc82e49c4df4ee1e7f323305e5a671536d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c092e7d1e089d0585bfdd520eb39fd92a93e822fbd1fc20dd7a7cd8b26a37885>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

1 e [SHBA terhiqet nga Iraku, forcat amerikane largohen plotesisht nga vendi](#)[Ngre siparin ekspozita e piktorit Pellumb Pucit ne kalane e Gjirokastrës](#)[Nafita rritet ndersa bise fundit](#)

Restaurohen manastiret e Gjirokastrës



28 Shtator 2026, 15:46Kulturë TEMA



Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në Gjirokastrë ka nisur ndërhyrjet restauruese në tre manastire të qarkut. Punimet kanë nisur në Manastirin e Dervicianit dhe në Manastirin e Dhuvjanit, monument kulture i kategorisë së parë, ku krahas restaurimit po punohet edhe për ngritjen e trapezarisë, për të vijuar më pas edhe në Manastirin e Mingulit.

“Në vijim të planit të investimeve dhe programit të parashikuar nga qeveria shqiptare dhe nga donatorët, ka filluar ndërhyrja në manastirin e Dervicianit është duke përfunduar ndërhyrja në manastirin e Duvjanit monument kulture i kategorisë së parë ku në bashkëpunim me World Monument Found është kryer dhe një investim për ngritjen e trapezarisë. Gjithashtu po vazhdon restaurimi i Teqesë së Koshtanit. Jemi në fazën finale të kësaj ndërhyrje si dhe po përgatitet fillimi i ndërhyrjes në manastirin e Mingul në bashkëpunim me Organizatën Trashëgimi Kulturore pa Kufij”, tha Ardis Duka, drejtor i drejtorisë rajonale të trashëgimisë kulturore.

Në këto objekte, ndërhyrjet synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e strukturave, si dhe mbrojtjen e vlerave dhe identitetit të tyre kulturor e historik.

“Ndërhyrje po kryhet në manastirin e Dervicianit, po kryhet ngritja e konakëve në faqen veriore të tyre. Ndërkohë Manastiri i Mingulit, po ashtu një objekt shumë i rëndësishëm i kategorisë së parë në zonën e Lunxhërisë në bashkinë Gjirokastrë. Po përgatitet fillimi i restaurimit total të këtij objekti duke përfshirë të gjitha ndërhyrjet, konservimin dhe restaurimin e fasadave, çatisë edhe elementët e tjerë përbërës të këtij objekti”, shtoi Duka.

Ndërhyrjet restauruese synojnë të garantojnë ruajtjen e këtyre monumenteve të trashëgimisë kulturore, duke i mbrojtur nga degradimi dhe duke siguruar vijueshmërinë e tyre për brezat e ardhshëm. A.K./TemA



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Ngre siparin ekspozita e piktorit Pëllumb Pucit në kalanë e Gjirokastrës](#)

09:34 Kulturë

Faik Islami, një jetë mes fjalës, vuajtjes dhe së vërtetës

21:46 Kulturë

[Duke filluar nga 3 tetori Festivali Ndërkombëtar i Kërcimit kthehet në Tiranë](#)

17:50 Kulturë

[VIDEO/ "Paraja nuk është vlerë", regjisori Kriks Dumo: Dëshira për sukses dhe kurthi i parave të shpejta](#)

17:00 Kulturë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.